



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve

BURSA PËR KURSIN VEROR TË GJUHËS, LETËRSISË DHE KULTURËS ÇEKE

Në kuadër të Programit *“Summer Schools of Slavonic Studies in 2017”*, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Çekisë ofron 2 (dy) bursa për pjesëmarrje në kurset verore të gjuhës, letërsisë dhe kulturës çeke të studentëve, mësuesve dhe specialistëve shqiptarë. Kurset do të mbahen për një periudhë intensive 4-javore në 3 nivele (fillestar, i mesëm dhe i avancuar) pranë Universitetit të Karlit (Charles University) në Pragë në datat 28 korrik - 25 gusht 2017 dhe pranë Universitetit Masaryk në Brno në datat 15 korrik - 12 gusht 2017.

Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, brenda datës **24 shkurt 2017**, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke;
Formularin e aplikimit (mund ta shkarkoni në faqen web <http://www.msmt.cz/file/39621/>);
2. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe II të studimeve të larta ose pasuniversitare;
3. Kopjen e noterizuar të Supplementit të Diplomës ose listën e notave;
4. Vërtetim nga universiteti përkatës për aplikantët që ndjekin aktulisht studimet universitare/pasuniversitare;
5. Fotokopjen e faqes së pasaportës;
6. 2 (dy) fotografi;

Preferohen kandidatët që kanë njohuri bazë të gjuhës Çeke.

Pala çeke përballon shpenzimet për ushqimin, akomodimin dhe programin mësimor dhe kulturor, ndërsa shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Për më shumë informacion referojuni në faqen e internetit:

<http://www.msmt.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies?highlightWords=summer+courses;>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE